

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për Krime të Rënda, ne përbërje nga gjyqtari Vesel Ismaili kryetar i trupit gjykues, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Nurije Rexhëbeqaj, në çështjen penale kundër të akuzuarve: _____ nga _____, për shkak të veprës penale: Lëndim i Rend trupor nga neni 189 par.2 lidhur me par.5 te KPRK-së, dhe _____ nga _____, për shkak të veprës penale: Pjesëmarrje ne Rrahje nga neni 190 par.1 te KPRK-së, te akuzuar sipas aktakuzës se Prokurorisë Themelore ne Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.17/2018 te dt. 28.02.2018, pas Zhvillimit te shqyrtimit gjyqësor, ne prezencën e prokurorit te shtetit Shemsije Asllani, të akuzuarve _____ dhe _____, me mbrojtësin e tij av. _____ nga _____ i angazhuar me autorizim, me dt. 29.03.2018, mori dhe të njëjtën ditë publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

Te akuzuarit:

_____, i biri i _____ dhe nenës _____ e gjinisë _____ i lindur me dt. _____ në fsh. _____ Komuna e _____ tani me vendbanim në _____ lagjja “ _____”, Rr. “ _____”, pa nr., i martuar, ka te kryer shkollën e mesme, i gjendjes se dobët ekonomike, me profesion menaxher i lokalit “ _____”, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës, ka qene nene masën e paraburgimit nga dt. **25.01.2018**, deri me dt. **29.03.2018**.

_____, i biri i _____ dhe nenës _____, e gjinisë _____ i lindur me dt. _____, në fsh. _____ Komuna e _____ tani me vendbanim në _____ lagja “ _____”, Rr. “ _____”, pa nr., i martuar, baba i _____ fëmijëve, me profesion punëtorë privat, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës se Kosovës.

JANE FAJTOR

Sepse:

Te akuzuarit:

_____ me dt. 21.01.2018, ne ora 03:00 h, pas mesnate ne lokalin “ _____”, ne Rrg. “ _____”, në _____ te dyshuarit _____ dhe _____, që te dy vëllezër, pas një mosmarrëveshje te atë çastshme me te dëmtuarin- kamerieret _____, dhe _____ lidhur me muzikën për te lëshuar pas mesnate i pandehuri _____ përdore thikën si mjet të rrezikshëm i cili ka pas me vete dhe e godet një here ne shpine ne pjesën torakale si dhe dy here ne shpine ne pjesën lumbale te dëmtuarin _____ me këtë i ka shkaktuar lëndime te renda trupore kurse të dëmtuarin _____ godet në anën e majte të toraksit, majtas nen mjekër dhe ne bërrylin e majtë duke i shkaktuar lëndime te lehta trupore dhe të njëjtit ikin me shpejtësi nga vendi i ngjarjes.

Me këtë i ka kryer veprën penale: Lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par2, lidhur me par 5, të KPRK-së.

si ne dispozitivin e pare te kësaj aktakuze, i pandehuri kishte përdorur gotën me te cilën e kishte goditur punëtorin-kamerierin duke i bashkangjitur vëllait te tij te pandehurit për ti shkaktuar lëndime te renda trupore personit te lartcekur.

Më këtë ka kryer veprën penale: Pjesëmarrje ne rrahje nga neni 190 par. 1, të KPRK-së,

Prandaj, gjykata konform dispozitave 3, 4, 17, 21, 41, 43 par.1.2, dhe 1.3, si dhe nenit 73, 74, te KPRK-se, si dhe nenit 273 par. 1, lidhur me nenin 31 te KPRK-së, dhe nenit 450 par.1,2 dhe 3, dhe neni 359, 360, 365, të KPPRK-së, i :

GJYKON

Te akuzuarin: për veprën penale: Lëndim i rend truporë nga neni 189 par. 2, lidhur me par 5 te KPRK- së, dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 3 (tri) vite e 6 (gjashte) muaj, ne te cilën dënim do ti llogaritet koha e kaluar nene masën e paraburgimit prej dt. **25.01.2018**, deri me dt. **29.03.2018**.

Te akuzuarin: për veprën penale: pjesëmarrje ne rrahje nga neni 190 par.1, te KPRK-së dënim me gjobe ne shume prej 600 (gjashtëqind) euro.

I akuzuari dënimin e shqiptuar eshte i obliguar qe ta vuaj ne afatin ligjore prej 15 (pesemdhjete) ditëve nga dita e plotfuqeshmirise se këtij aktgjykimi, kurse i akuzuari gjobën e shqiptuar gjithashtu eshte i obliguar qe ta paguaj ne afatin ligjore prej 15 (pesemdhjete) ditëve nga dita e plotfuqeshmirise se këtij aktgjykimi.

Ne qofse i akuzuari gjobën e shqiptuar nuk e paguan ne afatin e parapare ligjore gjykata te njëjtin do t'ia zëvendësoj ne dënim burgu duke ja llogaritur per nje dite burgim me nga 20 (njëzet) euro.

Obligohen te akuzuarit që secili veç e veç t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale, aq sa do të jenë sipas fletëshpenzitorës të kësaj Gjykate, ndërsa shpenzimet në emër të paushallit gjyqësorë secili vec e vec, shumën prej 50 (pesëdhjetë) €, brenda afatit ligjore prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Palët e dëmtuara dhe per realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen ne kontest civilo-juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Prishtine, Departamenti për Krime te Renda, ka paraqitur aktakuzë PP/I.nr.17/2018 te dt. 28.02.2018, kundër të akuzuarve për veprën penale: Lëndim i

rend truporë nga neni 189 par. 2, lidhur me par 5 te KPRK- së, dhe për veprën penale
Pjesëmarrje ne rrahje nga neni 190 par.1, te KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale Gjykata zhvilloi seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 29.03.2018, ku
prezantuan prokurori i shtetit, i akuzuari me mbrojtësin e tij
avokati dhe i akuzuari

Pas leximit te aktakuzës nga prokurori i shtetit, te akuzuarve ju dha mundësia e deklarimit lidhur me
aktakuzën.

I akuzuari deklaron se ne tërësi e kuptoj akuzën, veprën penale për te cilën
akuzohem dhe njeherit e pranoj fajësinë për kryerjen e veprës penale për te cilën akuzohem, kete e
beje pas konsultimit te mjaftueshëm me avokatin tim, pendohem jashtëzakonisht thelle për kryerjen
e kësaj vepre penale, i premtroj gjykatës se nuk do te përsëris veptra te tilla apo çfarë do qofshin ato, e
lus gjykatën qe te me shqiptoj nje dënim sa me te bute te mundshëm, i cili dënim do te ketë efektin
pozitiv te unë qe ne te ardhmen mos te përsëris veptra te tilla.

Mbrojtësi i te akuzuarit avokati deklaron se pranimi i fajësie
nga i mbrojturi ime është arritur pas konsultimit te mjaftueshëm me mua, dhe pasi i ka kuptuar
pasojat dhe bëni fitet e pranimi te fajësisë, i cili pranim është i mbështetur ne provat materiale te
cilat gjenden ne shkresat e lendes, andaj gjykatës i propozojmë qe te aprovoj pranimin e fajësisë, dhe
te aplikoj dispozitat ligjore te zbutjes se dënimi, te ketë parasysh moshën e tij te re, se është i
punësuar, i pa dënuar me pare, pranimin e fajësisë dhe ti shqiptoj dënim nen minimum te parapare
ligjor.

I akuzuari deklaron, se e kam kuptuar ne tërësi aktakuzën, veprën penale per te cilën
akuzohem, nuk kam nevojte per ndonjë sqarim shtese, e ndjej veten fajtor për veprën penale,
pendohem jashtëzakonisht thelle per kryerjen e kesaj vepere penale, i premtroj gjykatës se me nuk do
te përsërisë asnjë vepër te tille penale apo çfarë do qofshin ato, dhe e lus gjykatën qe te me shqiptoj
dënim sa me te bute.

Prokurori i shtetit deklaron; se pajtohem ne tërësi me pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarve,
lidhur me veprën penale, dhe ajo është ne përputhshmëri me te gjitha provat dhe faktet qe janë
prezantuar ne gjykate për veprimet e tyre inkriminuese, andaj gjykata duhet ti ketë parasysh te gjitha
rrethanat lehtësuese, dhe ato renduese, dhe te dënoi sipas ligjit.

Nisur nga fakti se te akuzuarit e kane pranuar fajësinë për veprën penale për te cilën akuzohen,
gjykata nuk e zhvilloi fare procedurën e provave, por ne mase te mjaftuar vërtetoi se ne veprimet e
te akuzuarve sajohen te gjitha elementet qenësore te veprave penale për te cilat akuzohen.

Me rastin e matjes, llojit dhe lartësisë se dënimit gjykata mori parasysh te gjitha rrethanat
lehtësuese dhe renduese qe ndikojnë ne llojin e dënimit ndaj te akuzuarve ne pajtim me nenin 73 te
KPRK-së, andaj si rrethana lehtësuese për te akuzuarin mori parasysh sjelljen e tij
ne gjykatore, pendimin e tij te thelle për kryerjen e kësaj veprës penale, moshën e tij relativisht te re,
nga e te akuzuarit, ndërsa si rrethane veçanërisht lehtësues mori pranimin e fajësisë
rrezikshmërinë e shkaktuar te dëmtuarit, dhe se ndaj tij është duke u zhvilluar edhe një procedure
tjetër penale, ndërsa për te akuzuarin gjykata si rrethana lehtësuese mori parasysh
pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, premtimin se ne te ardhmen nuk do te përsërisë asnjë

vepër penale te njëjte apo çfarë do qofshin ato, se me pare nuk ka qene i dënuar, ndaj tij nuk zhvillohet procedure tjetër penale, ndërsa si rrethane veçanërisht lehtësuese mori pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit, ndërsa si rrethane renduese gjykata mori parasysh peshën e rend te veprës penale, dhe rrezikshmërinë e shkaktuar te dëmtuarve, andaj te akuzuarve ju shqiptoj dënimin si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi me bindje se dënimi i shqiptuar është adekuat me shkallen e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallen e përgjegjësisë penale te te akuzuarve dhe se me këtë dënim do te arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 41, te KPPK-së.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale kundër të akuzuarve, do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë, duke pasur për bazë nderlikueshmërinë e veprës penale, kohëzgjatjen e zhvillimit të procedurës penale si dhe gjendjen pasurore të të akuzuarve, konform nenit 450 par.1, par.2, par. 3, të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 359, 365, të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr. 56/18, dt.29..03.2018**

Sekretarja juridike
Nurije Rexhëbeqa

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari
Vesel Ismaili

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 dite
nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.